

**Fjala e Sekretares së Përgjithshme të RCC-së,
znj. Majlinda Bregu,
6 dhjetor 2022**

Shkëlqesi,

Samiti i parë BE-BP në rajonin tonë, aq më tepër në qytetin tim të lindjes, Tiranë, është *domethënës në shumë mënyra*. Ai përfaqon të gjitha të mirat që ofron BE-ja, duke sjellë një fillad të ri në ndjekjen dinamikës së gjithëpërfshirjes midis vendimmarrësve të BE dhe vendimformësuesve të BP.

Për të punuar për konektivitetin politik BE-BP dhe për ta mbajtur atë gjithëpërfshirëse duhet punë.

Megjithatë, çfarë do ta bënte kthente këtë samit nga simbolik në historik, janë rezultatet që arrijmë dhe angazhimi i përbashkët drejt një procesi të vendosur e të përshpejtuar integrimi në BE.

Një prioritet i tillë gjeopolitik për BE-në dhe për vetë rajonin nuk garanton *asgjë më pak*. Fatkeqësisht, *konteksti nuk mund të ishte më i ndryshëm që prej takimit tonë në Brdo*, me ndryshime të jashtëzakonshme të ndodhura që prej atëherë e deri tani.

Në të gjithë Ballkanin Perëndimor ndikimet e luftës në Ukrainë mund të grupohen në tre shqetësime kryesore: rënia ekonomike, siguria ushqimore dhe energjetike, siguria dhe sigurimi kombëtar.

Ndërsa flasim, *rajoni ynë dridhet nga pasiguria energjetike*, më së shumti në përballimin e cmimeve dhe inflacionit që ka kapërcyer *deri në 25%*, ndërkohë që rritjet e çmimeve të konsumit mund të shtyjnë edhe *13% të popullsisë sonë* në varfëri.

Edicioni ynë i veçantë i *Barometrit Ballkanik* për sigurinë, *identifikon edhe shenja inkurajuese ku duhet të mbështetemi*, me 83% të të anketuarve që mendojnë se *bashkëpunimi rajonal mund të kontribuojë për një qëndrueshmëri më të mirë ekonomike*.

Konsensusi i gjerë për bashkëpunimin rajonal, që është një *tipar konstant* i të gjitha anketave, është *shtylla* më e fortë për veprimet tona të bazuara në dijeninë e ndërgjegjshme të faktit se interesat tona nuk mundet të ndahen nga ato të fqinjëve dhe që *bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës jep rezultate të drejtpërdrejta për personat të cilëve ai u drejtohet, qytetarëve tanë*.

Bashkëpunimi i fortë dhe integrimi i rajonit në masat e përbashkëta të BE-së në fushën e *sigurisë energjetike dhe agjendës së gjelbër* mbeten prioritet dhe në këtë drejtim *Paketa e mbështetjes energjetike e BE-së prej 1 miliardë eurosh ka vlerë të jashtëzakonshme*.

Nuk është e nevojshme të hedhësh vështrimin përtej tre marrëveshjeve rajonale të mobilitetit, të nënshkruara gjatë Samitit të Berlinit që mundësojnë mobilitetin akademik dhe profesional dhe ofrimin e shërbimeve në një treg të përbashkët rajonal, apo progresin e bërë në zgjerimin e korridoreve të gjelbra në kufijtë mes BP dhe BE për të parë ndikimin e prekshëm të bashkëpunimit rajonal. Prej kësaj jave, do të kemi 3 vende anëtare të BE-së që zgjerojnë korridoret e gjelbra ose korridoret blu me Ballkanin Perëndimor: Greqia, Italia dhe Kroacia. Ne shpresojmë se të tjerë do ti bashkohen kësaj nisme sa më parë të jetë e mundur.

Zonja dhe zotërinj,

Meqenëse shoqëritë dhe qeniet njerëzore nuk mund të mbijetojnë pa një nivel të caktuar pritshmërie dhe rregullimi, ne e nisëm ditën me *nënshkrimin e Deklaratës së Roaming-ut, e cila rregullon uljen e çmimeve të shërbimeve roaming ndërmjet rajonit dhe BE-së. Procesi sfidues vetërregullator dhe i uljes vullnetare, i shoqëruar me reforma të forta politikash nga ana e qeverive, do të ulë ndjeshëm tarifën e shërbimit roaming të të dhënave që nga 1 tetori 2023. Uljet do të vazhdojnë derisa të arrihet objektivi fundor i çmimeve të shërbimit roaming, që ato të arrijnë afër niveleve të çmimeve kombëtare deri në vitin 2027.*

Negociatat për të arritur një marrëveshje nuk janë kurrë të lehta. Ndonjëherë janë dhëmbë për dhëmbë.

Por, sërish sot, nënshkrimi tregoi se:

- BP-ja mund të jetë një skenë e politikave konkurruese dhe mosmarrëveshjeve, madje edhe frustrimeve,

megjithatë ekziston një hapësirë e madhe për të vepruar së bashku, e motivuar nga të kuptuarit konsensual të progresit.

- afrimi i njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, flet për perspektivë pozitive të lidhshmërisë për hir të qëllimit, jo rastësisht.

- ne mundemi, sepse ne kemi dhënë prova për këtë.

Shpresoj që fryma e ndezur dhe e gjallërishtme e Tiranës sime të ketë ndikim pozitiv mbi punën tonë të përbashkët në të ardhmen, pasi ne na duhet të punojmë më shumë së bashku: si rajon, si familje evropiane, dhe si komunitet ndërkombëtar.